

Zhvillohet takimi i VI vjetor i TFMA-së dhe seminari mbi “Dixhitalizimin e shërbimeve publike të ofruara nga Bashkitë”, Vilnius, Lituani më 19-20 tetor, 2022

Në datat 19-20 tetor 2022, u zhvillua në Vilnius të Lituanisë takimi i VI vjetor i Task Forcës së EUROSAT-t për Auditimin e Bashkive (TFMA), si dhe seminari me temë “Dixhitalizimi i shërbimeve publike të ofruara nga Bashkitë”.

Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 26 Institucione Supreme të Auditimit, dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit si një nga SAI-t anëtare të kësaj Task Force, u përfaqësua nga audituesit Ermira Vojka, Redina Karapici dhe Salvi Deda.



Në fjalën përshëndetëse, Kryetari i SAI-t mikpritës, Lituanisë, i cili hapi dhe punimet e këtij takimi, theksoi rëndësinë e këtij aktiviteti të përvitshëm, në shkëmbimin e eksperiencave nga të gjithë pjesëmarrësit, lidhur me sfidat dhe risitë me të cilat përballen audituesit gjatë auditimit të bashkive në vendet e tyre.



Fokusi i seminarit të këtij viti ishte ndarja e eksperiencave dhe diskutimi i problematikave, mangësive apo zgjidhjeve të mundshme sa i takon ofrimin të shërbimeve nga bashkitë në formë të dixhitalizuar, tranzicioni dixhital që po pëson Europa, si dhe mundësitë për rritje e zhvillim në të ardhmen. Në vijimësi pjesëmarrësit nga disa SAI, prezantuan rezultate të auditimeve apo vlerësime të ndryshme mbi shërbimet e dixhitalizuara në vendet e tyre. Kështu, KLSH prezantoi materialin me temë “*Akcesi i qytetarëve në shërbime të dixhitalizuara*”, SAI i

Izraelit prezantimin me temë “*Koordinimi mes qeverisë lokale dhe qendrore për dixhitalizimin e shërbimeve*”, SAI i Spanjës prezantimin me temë “*Implementimi i E-Qeverisjes në bashkitë e mëdha*”, si dhe SAI i Maqedonisë së Veriut, materialin me temë “*Cilësia e shërbimeve të NjQV nëpërmjet portaleve të tyre*”.

Punimet e ditës së dytë, u fokusuan tek diskutimet e SAI-ve të angazhuara në zhvillimin e aktiviteteve të dakordësuara nga viti paraardhës, ku u prezantuan rezultatet e punës së tyre kryesisht, lidhur me implementimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel vendor, menaxhimin e borxheve të bashkive, zhvillimin e bazave të të dhënave të tyre, etj.

Pjesëmarrësit e ndarë në 3 grupe, diskutuan lidhur me përdorimin e shërbimeve elektronike dhe grupi i tretë, i cili kishte në përbërje 15 pjesëmarrës në sallë dhe disa pjesëmarrës online, u moderua nga përfaqësuesja e KLSH-së znj. Ermira Vojka. Në fokus të diskutimit ishte gjenerimi i ideve lidhur me temën *“Përmirësimi i mundësive të qytetarëve në përdorimin e shërbimeve online”*, duke diskutuar specifikisht mbi tre drejtime si: thjeshtëzimi i mjeteve dhe elementëve që përbëjnë një shërbim online, nevoja e shërbimeve *“one stop shop”*, mënyrat e informimit dhe inkurajimit të qytetarëve për të përdorur këto shërbime, si dhe përfshirja e qytetarëve me qëllim përmirësimin e shërbimeve elektronike.



Në përfundim, përfaqësuesit diskutuan dhe votuan mbi temat dhe aktivitetet ku do të përqendrohet Task Forca për Auditimin e Bashkive gjatë vitit në vijim, dhe u dakordësua se tema e seminarit të ardhshëm, do jetë mbi *“Ndarjen dhe përdorimin e transfertave dhe granteve nga bashkitë”*, ndërkohë që tema për shkëmbimin e eksperiencave të auditimit, do të vendoset në vijim midis dy propozimeve, *“Auditimi i shërbimeve të transportit rrugor”* dhe *“Auditimi i masave të marra nga bashkitë për menaxhimin e krizave apo rasteve të emergjencave civile”*, kjo e fundit propozuar nga përfaqësuesit e KLSH-së.